



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
AKADEMIA E SIGURISË

Nr. 2360/1 Prot.

Tiranë, më 03 .09.2024

Lënda: Dërgohen për shpallje të kriterëve për pozicionin Specialist për Shërbimet Mbështetëse

NJOFTIM

AGJENSISË SË PROKURIMEVE PUBLIKE

TIRANË

Akademia e Sigurisë shpall konkursin për 1(një) vend pune të lirë për personel administrativ, klasa IV-2, funksioni Specialist për Shërbimet Mbështetëse, në Akademinë e Sigurisë.

Kandidatët e interesuar për këtë vend pune duhet të plotësojnë këto kriterë ;

1- Kriteret e Përgjithshme

1. Te jete shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të ketë përfunduar arsimin e lartë në “Fakultetin Ekonomik” në nivel “Bachelor” dhe “Master Shkencor”;
3. Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
4. Gjatë kryerjes së profesioneve të mëparshme të mos jetë larguar me masa disiplinore;
5. Të ketë figurë të pastër morale ;
6. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë;

2- Kriteret e veçanta

1. Të ketë eksperiencë pune në sektorët ekonomike jo më pak se 3 vjet përvojë;
2. Të jetë i/e aftë të përpilojë dhe analizojë shkresa dhe raporte zyrtare;
3. Të demonstrojë aftësi operative, aftësi të mira komunikuese, menaxhuese;
4. Të ketë aftësi për të punuar në grup;
5. Të ketë njohuri shumë të mira kompjuterike;
6. Preferohet të zotëroje gjuhën Italiane dhe Angleze;

3- Kandidatët konkurrues duhet të paraqesin në Akademinë e Sigurisë dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim.
2. Referencë nga punëdhënësi i mëparshëm .

3. Jetëshkrimi profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
4. Kopje të njehsuar të dokumenteve diplomë (përfshirë dhe listë notash, letërnjoftimi (ID). Diplomati që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
5. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim Gjykatë dhe Prokurorie.
8. Vërtetim i gjendjes shëndetësore;
9. Vërtetim nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK);
10. 2 fotografi me permasat 4x6.
11. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Detyrat

- Harton informacione e relacione për eprorët lidhur me problemet që lindin gjatë procesit të shërbimeve që mbulon apo shkresa të ndryshme që ka në ndjekje dhe propozon marrjen e masave të nevojshme për zgjidhjen e tyre;
- Asiston Shefin e Sektorit Ekonomik në të gjitha problemet që kanë të bëjnë me zbatimin e politikave, organizimin dhe drejtimin e shërbimeve ekonomike;
- Specialisti i shërbimeve është anëtar i skuadrës administrative në Strukturën Administrative me përgjegjësi për sigurimin e kushteve të mira jetese, mjedisi argëtues, sigurimin me veshmbathje, armatim dhe bazë materiale të nevojshme të këtyre shërbimeve, nëpërmjet bërjes së kërkesave të vazhdueshme dhe fondeve të miratuara;
- Punon për ndjekjen, zbatimin e akteve ligjore, vendimeve, urdhërave dhe udhëzimeve që normojnë punën në shërbimet që mbulon;
- Harton specifikimet teknike për artikujt që do të prokurohen;
- Merr pjesë në kolaudimin sasior e cilësor të mallrave, veshmbathjes dhe artikujve të tjerë duke iu referuar kontratave të lidhura apo dokumenteve të prokurimit me vlerë të vogël;
- Merr pjesë në komisionin e prokurimit sa herë shqyrtohen ofertat për artikujt të ndryshëm, për shërbimet e veshmbathjes, transportit, paisjeve etj;
- Si specialist i shërbimit bën zbërthimin dhe detajimin e planit material-financiar, ndjek realizimin e tij sipas regjistrit të parashikimit të prokurimeve për të gjithë nevojat e shërbimeve.

Dokumentat dorëzohen pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Akademinë e Sigurisë, brëndave 5 (pesë) ditëve pune nga momenti i shpalljes.

Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Bashkëlidhur CD, me të dhënat për publikim.

